

## **STATUTI I SHOQERISE TREGTARE**

### **“NORD-EST-INVEST 2022” SH.P.K**

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe Ligjit Nr.9273 date 03.07.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, me date 20.06.2023 u krijua Shoqeria Tregtare “NORD-EST-INVEST 2022” SH.P.K, me Ortaket shtetasin Dorian Shiqerukaj, i datelindjes 15.06.1984, lindur ne Bajram Curri, dhe banues ne Durres, identifikuar me Karte identiteti Nr.I40615086C , shtetasin Rifat Toska i datelindjes 26.11.1974 , lindur Markaj dhe banues ne Tirane i identifikuar me Karte identiteti Nr.H41126119D, shtetasin Blerim Toska i datelindjes 15.06.1987, lindur dhe banues ne Barjam Curri , cila do te funksionojne ne baze te ketij STATUTI.

### **LLOJI DHE EMRI SHOQERISE**

#### **NENI 1**

Lloji I Shoqerise Tregtare eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe emri i saj eshte “NORD-EST-INVEST 2022”SH.P.K.

### **ZYRA QENDRORE DHE TERRITORI**

#### **NENI 2**

Zyra Qendrore e Shoqerise Tregtare “NORD-EST-INVEST 2022”SH,P,K

BAJRAM CURRI Tropoje, me nr.pasurie 12/94, Zone Kadastrale 1347 me adrese zyrat e ndermarrjes se perpunim drurit tek kodra e zallit ,truall prone e shtetit.

#### **NENI 3**

Veprimtarine e saj Shoqeria Tregtare “NORD-EST-INVEST 200”SH.P.K, ka te drejte ta ushtroje ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj.

### **OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA**

#### **NENI 4**

Shfrytezim pyjesh, perpunim i lendes drusore, eksport - import te prodhimeve te drurit, tregtim te mallrave te ndryshem industriale e ushqimore, tregtim te prodhimeve bujqesore e blegtorale. Permiresimin e pyjeve (ricungime e trajtim pyjesh me prerje kulturore). Shfrytezim i qendrushem i pyjeve. Ndertimi e rrugeve pyjore Grumbullimi dhe vjelja e qendrueshme e prodhimeve pyjore dhe flores spontane mjekesore e tanifere. Ushtrimi i gjuetise sportive e turistike te faunes se eger etj. Transport i materialeve drusore me mjetet e vete shoqerise. Punime te ndryshme ndertimi, punime dheu, murature e betoni, ndertime civile, kanalizime, rruge, ujesjellesa, rikonstruksione, prodhime materialesh ndertimi etj. Bar kafe, restorant. Kerkime,

zbulime dhe shfrytezime minerare. Hartimi dhe zbatimi i planeve te menaxhimit ne pyje. Mbledhje dhe perpunimi i farave, prodhimi i fidaneve, kultivimi dhe mbjellja e tyre. Punime ne pyllzime, rehabilitime, sherbime kulturore, permiresime dhe ripertitje pyjesh, luftim insektesh dhe semundjesh. Ndertim pritash malore, lera (betoni e plasmasi), garbione, ndertim gjerdesh, punime ne kullota e livadhe. Punime kujdesimi ne pyje me statusin e Zones se Mbrojtur. Krijimin e 2 infrastruktures per pritjen e vizitoreve , ndertim belvedere, vendosja e tabelave, kulla vrojtimi dhe sinjalistika e nevojshme. Prodhim i produkteve te drurit per mobileri dhe per djegie ne fushen e perpunimit aktiv. Prodhim i mobilerive te ndryshme dhe tregtimin e tyre brenda dhe jashte vendit. Prodhim i produkteve te drurit per djegie si briket, pellet etj. dhe tregtimin e tyre brenda dhe jashte vendit. Grumbullim, riciklim, perpunim, transportim i mbetjeve te drurit. Perpunim i lendes drusore dhe prodhim pelleti nga mbetjet e saj. Konsulence teknike ne fushen e pergatitjes se strategjive, politikave, programeve dhe planeve kombetare te zhvillimit te sektorit te pyjeve, sherbime te ekspertizes dhe certifikimit ne fushen e pyjeve dhe mjedisit. Sherbime profesionale per studime dhe aplikime profesionale ne pyje dhe kullota, per hartimin e projekteve te zhvillimit te baseneve, per hartimin e planeve te manaxhimit te pyjeve, kullotave dhe zonave te mbrojtura, per hartimin e projekteve tekniko-organizative te shfrytezimit ne pyje dhe ne hartimin e projekteve te permiresimit te pyjeve, projektme ne fushen e prodhimit te fidaneve dhe administrimit te fidanishteve, zbatim punimesh ne fushat e pyllzimit dhe permiresimit te pyjeve, vleresim te ndikimeve ne mjedis. Studim, projektim dhe zbatim punimesh/sherbimesh dhe mirembajtje ne agrikulture, hortikulture, florikulture, mjedis, pyje, kullota, mbareshtim faune, bime medicinale, fidanishte, siperfaqe te gjelberta parqe, pyje, pastrim e dekor, mbrojtje bimesh. Prodhimi dhe tregtimi i materialit mbjelles dhe shumezues bimor, farna, fidane pyjore, arror, frutor, agrume, medicinale, tanifere, eterovajore, bime dekorative (lule, shkurre dhe drure), import- eksport i tyre. Prodhim, tregtim dhe mbjellje i luleve, pemeve dhe shkurreve dekorative. Punime te inxhinierise se mjedisit (ambjentale), arkitekture, peisazheve, kopshtarise (gjelberim-pyllezime) hidrombjellje, mbrojtje skrapatash, hidrodrenazhime, drenazhe punime hidrologjike, mjedisore. Rregullim, sistemim ambientesh te gjelberta, shkulje pemesh me makineri te posacme. Import - eksport dhe tregtim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial, produkte bujqesore, produkteve ushqimore, materiale ndertimi, pesticide, paisje elektrike, konfeksione etj. Import - eksport dhe tregtim me shumice e pakice te produkteve me origjine shtazore per njerezit. Import - eksport dhe tregtim me shumice e pakice te materialeve te pastrimit, dezinfektimit dhe detergjenteve te ndryshem. Import - eksport dhe tregtim me shumice e pakice te materjaleve 3 dhe paisjeve elektrike, elektroshtepiake (soba te llojeve te ndryshme si soba elektrike, soba per ngrohje me dru, soba per ngrohje me pellet, soba per ngrohje me briket, frigorifere, lavatriçe, lavastovilje, dhe çdo pajisje tjeter elektroshtepiake etj). Import - eksport dhe tregtim me pakice dhe shumice te artikujve e mallrave te ndryshem dhe tregtimi i tyre. Transport te mallrave te ndryshem per vete dhe per te trete. Cdo aktivitet tjeter qe nuk bie ndesh me legjislacionin ne fuqi. Eksport i mbetjeve te lendes drusore dhe eksport pelleti. Tregtim. Montim, riparim, dhenie me qera te kaldajave te te gjitha llojeve. Tregtim te materiaieve kancelarie e kompjuterike. Shoqeria do te zhvilloje aktivite ndertimi objektesh dhe rruges, shitblerjeje,

menaxhimi dhe dhenie me qera te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme. Import-eksport dhe tregti me shumice e pakice te naftes, gazit, nenprodukteve te tyre, vajrave lubrifikante dhe cdo lloji hidrokarburi. Punime dhe kanalizime per rrjetet e jashtme dhe te brendshme te ujesjellesve e te cdo rrjeti tjetere te sistemit hidrik. Konsulence juridike e financiare ne fushen tregtare e civile. Veprimtari ne fushen e Agro Turizmit dhe investime ne funksion te veprimtarise se Agro Turizmit. Tharje material drusor me furra me impiant gazi, diezel, pellet dhe mbetje druri.

#### **NENI 5**

Shoqeria Tregtare "NORD-EST-INVEST 2022" SH.P.K., do te kryej veprimtarine dhe aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

### **KAPITALI I SHOQERISE**

#### **NENI 6**

Kapitali Themeltar I regjistruar I Shoqerise Tregtare "NORD-EST-INVEST 2022" SH.P.K., perbehet prej 100000 ( njeqindemije) leke, ne vlere nominale e 3( tre ) kuota.

Ortaket kontribojne ne keto vlere:

1-Dorian Shiqerukaj kontribon ne vlere 34000 mije leke zoterues i 1 kuote qe perben 34% te kapitalit te shoqerise.

2-Rifat Toska kontribon ne vlere 33000 mije leke zoterues i 1 (nje) kuote qe perben 33% te kapitalit.

3- Blerim Toska kontribon ne vlere 33000 mije leke zoterues i 1 (nje) kuote qe perben 33% te kapitalit.

Ne funksion te zgjerimit apo te t'kurtjes se veprimtarise se shoqerise mund te zmadhohet apo zvogelohet kapitali i shoqerise.

Ne rast riorganizimi te dy ose me shume shoqerive, me ane bashkimi, kapitali themeltar i shoqerise tregtare "NORD-EST-INVEST 2022" SH.P.K. do te zmadhohet ne qofte se kjo e fundit do te jete shoqeri perthithese.

### **TRANSFERIMI KAPITALIT**

#### **NENI 7**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a- Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b- Shitblerjes
- c- Trashegimise

- d- Dhurimit
- e- Cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

## ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

### Asambleja e Pergjithshme

#### NENI 8

Asambleja Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

- a- Ndryshimin e statutit
- b- Emerimin e shkarkimin e administratoreve
- c- Emerimin e shkarkimin i likujdvesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- d- Percaktimin e shperblimeve per administratoreve,likujdatoreve dhe eksperteve te autorizuar.
- dh-Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pegatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- f- Zmadhimin e zvogelimin e kapitalit.
- g- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- h- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- i- Riorganizimin e prishjen e shoqerise.
- j- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.
- k- Ceshtjeve te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
- l- Nisjen e nje hetimi te posacem per ndonje parregullsi te kryer gjate ushtrimit te veprimtarise tregtare,duke caktuar nje ekspert te pavarur.
- m- Te kerkoje prane Gjykates shfuqizimin e vendimeve te administratorit kur ato jane ne shkelje te ligkit.
- n- Marrjen e cdo vendimi tjeter te parashikuar ne Ligjin "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare

## **NENI 9**

Vendimet duhet te rregjistrohen ne Rregjistrin e Vendimeve, te dhenat e te cileve nuk mund te fshihen apo te ndryshohen.

Duhet te rregjistrohen ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet:

Per miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimatrise.

Per shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve.

Per investimet dhe ato per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e parregjistruara ne Rregjistrin e Vendimeve jane absolutisht te pavlefshme.

## **NENI 10**

Mbledhja e zakonshme e Asamblese se Pergjithshme, si rregull, mblidhet te pakten nje here ne vit.

Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet sa here eshte e nevojshme per tu mbrojtur interesat e shoqerise, si dhe:

Nese sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton apo ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

Nese shoqeria do te shese apo dispoje ne ndonje menyre tjeter aktive, vlera e te cilave eshte me e larte se 5 perqind e aktiveve te shoqerise, te rezultuara ne pasqyrat e fundit financiare, te çertifikuara.

Nese shoqeria, Brenda dy viteve te par ate krijimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, vlera e se ciles eshte me e larte se 5 perqind e aseteteve te shoqerise, te rezultuara ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

## **NENI 11**

Asambleja e Pergjithshme thirret ne mbledhje nga Administratori/et i/e Shoqerise.

Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te rregjistrohen ne procesverbal, ku keta te fundit administrohen dhe ruhen nga administratori/et. Ne procesverbal duhet te pasqyrohet data e mbledhjes, rendi i dites, emri i mbajtesit te procesverbalit si dhe vendimi i marr.

Procesverbalit i bashklidhet edhe Akti i Thirrjes se Asamblese te Pergjithshme te shoqerise, akt i cili nxirret nga administratori/et.

## **NENI 12**

Ortaket e Shoqerise Tregtare "NORD-EST-INVEST 2022" SH.P.K., si ushtrues i vetem i tagrave te Asamblese se Pergjithshme, emeron nje ose me shume adminstratore te shoqerise. Periudha kohore e funksionit te adminstratorit/eve eshte 5 vjet, me te drejte riperteritje (riemerimi).

Me krijimin e Shoqerise Tregtare "NORD-EST-INVEST-2022" SH.P.K., funksionin e administratorit te shoqerise do ta kryej shtetasi:

ALBERT TOSKA , i datelinjes 06.07,1980 lindur dhe banues ne Barjam Curri.

Administratori/et kane te drejte e detyrohen te:

Kryejne te gjitha veprimet per adminstrimin e Shoqerise ne perputhje dhe ne zbatim te praktikave tregtare te caktuara nga Asambleja e Pergjithshme.

Perfaqeson/jne shoqerine tregtare.

Kujdeset/en per mbajtjen e sakte dhe te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel.

Pregatit/in bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise si dhe t'ja paraqes/in per miratim Asamblese se Pergjithshme.

Pregatit/in propozimin per shperndarjen e fitimit dhe t'ja paraqes/in per miratim Asambles se Pergjithshme.

Krijoj/ne nje sistem paralajmerimi per te evidentuar rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise apo dhe vete egzistencen e Shoqerise.

Kryej/ne cdo rregjistrim dhe te dergoj/ne cdo te dhene te detyrueshme, sikurse parashikohet ne Ligjin "Per Qendren Kombetare te Biznesit".

Raportoj/ne ne Asamblene e Pergjithshme mbi zbatimin e praktikave tregtare si dhe per realizimin e veprimeve te posacme qe jane me rendesi te vecante per Shoqerine.

Therras/in Mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

Ne menyre te detyruar duhet te therras/in Asamblene e Pergjithshme kur nga bilanci vjetor apo raportet e ndermjetme financiare rezulton apo egziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme Brenda tre muajve ne vazhdim.

Mos kryej/ne ndonje veprimtari apo funksion tjeter te cilat do te perbenin konflikt interesi, shkelje te besnikerise, abuzime ne detyre, hyrje ne konkurrence me shoqerine apo dhe cdo veprim tjeter qe vjen ne kundersizim me kriteret e percaktuara ne nenin 98 te ligjit.

Te leshoj certifikate te aftesise paguese.

Te administroj dhe ruaj kopjet e procesverbaleve te mbledhjeve te Asambles se Pergjithshme.

Ka/ne te drejten e marrjes se nje shperblimi baze si dhe te nje shtese mbi shperblimin, ne formen e fitimit apo te ndonje forme tjeter, i cili mund te reduktohet ne rast veshtiresie financiare nga Asambleja e Pergjithshme.

Ben/jne rregjistrimin e prishjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit.

Ben/jne njoftimin per rregjistrimin te likuidatori/eve te Shoqerise prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit.

Zbattoj/net e gjitha detyrimet e tjera te parashikuara ne ligj

## **PERFAQESIMI I SHOQERISE**

### **NENI 13**

Shoqeria Tregtare "NORD-EST-INVEST 2022" SH.P.K., perfaqesohet nga Ortaket e Shoqerise themelues, i cili ka kopetenca te plota per perfaqesimin e saj ne gjykate ndaj administratorit/ve apo ndaj te treteve si dhe te autorizoj cdo person per t'a perfaqesuar shoqerine.

### **NENI 14**

Ne rastin kur shoqeria tregtare "NORD-EST-INVEST 2022" SH.P.K., drejtohet nga administratore te jashtem ky/keta te fundit jane te detyruar te veprojnë Brenda tagrave te perfaqesimit dhe te veprimtarise se shoqerise, te zbatoje te gjitha kufizimet e tagrave te perfaqesimit, te percaktuara ne Statut dhe Ligj si dhe te zbatoje te gjitha vendimet dhe urdherat e ortakeve themelues te shoqerise.

## **BILANCI I TE ARDHURAVE**

### **NENI 15**

Veprimtaria financiare e shoqerise mbyllet cdo date 31 dhjetor te fundvitit, administratori/et dhe kontabilisti/et nxjerrin bilancin kontable shoqerise, rezultatit ekonomik te saj si dhe fitimin ose humbjen e shoqerise, ne perputhje me kriteret e percaktuara ne legjislacionin ne fuqi

#### **NENI 16**

Te ardhurat e shoqerise do te sigurohen prej aktivitetit te saj dhe do te formohen nga cmimet e shitjeve dhe tarifat e sherbimit, te cilat do te caktohen me vendim te ortakeve themelues duke u bazuar ne kerkese-oferten dhe legjislacionin ne fuqi.

#### **NENI 17**

Te ardhurat neto qe do te realizohen, pas zbritjes se tatim fitimit, krijimit te fondit te zhvillimit dhe detyrimeve te tjera, do te mbeten pasuri e ortakeve themelues te shoqerise.

#### **NENI 18**

Te ardhurat neto qe do te realizohen, pas zbritjes se tatim fitimit, krijimit te fondit te zhvillimit dhe detyrimeve te tjera, do te mbeten pasuri e ortakeve themelues te shoqerise.

### **MARRDHENIET E PUNES**

#### **NENI 19**

Marrdheniet e punes midis Shoqerise Tregtare "NORD-EST-INVEST 2022" SH.P.K., me cilesine e punedhenesit, si dhe te te punesuarve, me cilesine e punemarresit, rregullohen sipas dispozitave te Kodit te Punes dhe te Akteve Nenligjore te dale ne baze dhe per zbatimin e tij.

Bazuar ne dispozitat ligjore, referuar me siper, do te percaktohen ne kontraten e punes individuale paga, shtesat mbi pagen, koha e punes dhe e pushimit, sigurimet shoqerore dhe shendetsore etj.

#### **NENI 20**

Per cdo konflikt te lindur do te behen perpjekje per tu zgjidhur me marreveshje mes palesh dhe ne pamundesi te zgjidhjes se konfliktit me marreveshje palet kane te drejten t'i drejtohen gjykates kompetente te percaktuar ne ligj.



## **PRISHJA E SHOQERISE**

### **NENI 21**

Shoqeria Tregtare "NORD-EST-INVEST 2022" SH.P.K., mund te prishet ne rastet e percaktuara ne ligj.

Me perjashtim te rastit te nisjes se nje procedure falimentimi, prishja e shoqerise do te sjelle si pasoje hapjen e procedurave te likudimit ne gjendjen e aftesise paguese, sipas dispozitave te percaktuara ne ligj, me procedure te zakonshme apo te thjeshtezuar.

Likuidimi i shoqerise do te kryhet nga likudatori/ret, emeruar nga Asambleja e Pergjithshme Tregtare qe perbehet nga Ortaket e Shoqerise.

Ne Qendren Kombetare te Biznesit njoftohen per rregjistrim te dhenat e likuiduesit/sve dhe tagrat e tij/tyre per te perfaqesuar shoqerine se bashku me dokumentat perkatese.

### **NENI 22**

Likuiduesi apo likuiduesit, mbasi emerohet/n, merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e administratorit/eve dhe kryhen tere procedurat per mbylljen e veprimtarise se shoqerise nen mbikqyrjen e orteve themelues te shoqerise.

Likuiduesi/t pergatit/in nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likudimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave, te cilat miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise.

Pas shlyerjes se tere detyrimeve, aktivet e mbetura merren nga ortakeve themelues te shoqerise.

Mbas shperndarjes se aktiveve, likuiduesi/it njofton Qendren Kombetare te Rregjistrimit per perfundimin e likudimit dhe kerkon c'rregjistrimin e shoqerise.

### **NENI 23**

Likuiduesi apo likuiduesit, mbasi emerohet/n, merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e administratorit/eve dhe kryhen tere procedurat per mbylljen e veprimtarise se shoqerise nen mbikqyrjen e ortakeve themelues te shoqerise.

Likuiduesi/t pergatit/in nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave, te cilat miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise.

Pas shlyerjes se tere detyrimeve, aktivet e mbetura merren nga ortaku i vetem themelues i shoqerise.

Mbas shperndarjes se aktiveve, likuiduesi/it njofton Qendren Kombetare te Rregjistrimit per perfundimin e likudimit dhe kerkon c'rregjistrimin e shoqerise.

## **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

### **NENI 24**

Per Zgjidhjen e cdo ceshtje tjeter, qe do te linde gjate veprimtarise se Shoqerise e qe nuk parashikohen ne kete Statut, Organet Drejtuese duhet t'ju referohen dispozitave te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare "si dhe dispozitave te tjera ligjore.

**ORTAKET E SHOQERISE**

**DORIAN SHIQERUKAJ**

**RIFAT TOSKA**

**BLERIM TOSKA**

